

**Vendim nr. 6, datë 28.01.2026**

**(V-6/26)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 26.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (M) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUESE:**                   **MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E ZHVILLIMIT RURAL**, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Dritan Palnikaj dhe Glaudina Musaj e Ivana Dalipaj, me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**, përfaqësuar nga drejtore Enkela Dudushi.  
**ADELINA BISTRIT**, në mungesë.

**OBJEKTI:**                   **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3805, datë 03.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:**           **Nenet 4, pika 1, 42 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71, 71/a dhe 81 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkueses, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural (*kërkuesja*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Departamentit të Administratës Publike (*DAP*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Adelina Bistrit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i interesuar, Adelina Bistri, ka filluar punë në strukturat e kërkueses në vitin 2002 dhe në vitin 2010 është emëruar specialiste në Drejtorinë e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Mbështetur në urdhrin e datës 18.10.2013 të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së re, DAP-i, me shkresën e datës 13.11.2013, ka informuar kërkuesen se në përputhje me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, nëpunësit mund të sistemohen në vende të reja pune të krijuara ose të mbetura si pasojë e ristrukturimit.

2. Kërkuesja i ka propozuar subjektit të interesuar kalimin në pozicionin e specialistes në një institucion në varësi të saj, të cilin ajo e ka refuzuar dhe, më tej, me shkresën e datës 22.11.2013, e ka njoftuar për kalimin në listën e pritjes për shkak të pamundësisë për t’i ofruar një pozicion të njëjtë pune. Subjekti i interesuar e ka kundërshtuar njoftimin fillimisht në rrugë administrative dhe më pas i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar anulimin e akteve administrative të datave 13.11.2013 dhe 22.11.2013.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 160, datë 21.01.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se plotësoheshin kriteret ligjore për nxjerrjen në listën e pritjes. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 1560, datë 07.05.2014, e cila ka shfuqizuar aktet administrative dhe ka urdhëruar kthimin në vendin e mëparshëm të punës e detyrimin për dhënien e pagës nga data e kalimit në listën e pritjes deri në datën e kthimit, me arsyetimin se kërkuesja nuk ka respektuar përcaktimet e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Për rekursin e kërkueses, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2021-342 (26), datë 01.03.2021, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, bazuar në argumentin se gjykata e apelit duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve për t’u dhënë atyre mundësinë për të parashtruar të gjitha pretendimet e prapësimet e tyre dhe për t’u garantuar të drejtën e mbrojtjes.

4. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 44 (86-2024-51), datë 24.01.2024, ka vendosur sërish ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e padisë, rikthimin në të njëjtin pozicion pune ose në një pozicion të së njëjtës kategori, si dhe pagesën e pagës deri në rikthimin në punë, me argumentin se aktet administrative objekt kundërshtimi janë nxjerrë mbi një ligj të shfuqizuar, ndaj ajo ka disponuar për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve dhe zgjidhjen e pasojave juridike të

krijua. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuesja dhe DAP-i përmes Avokaturës së Shtetit.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3805, datë 03.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk paraqet shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

6. Në datën 12.02.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 21.02.2025.

7. Kolegji i Gjykatës, në datën 02.05.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit, në datën 13.05.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit, të ankimit efektiv dhe për t’u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura në rekurs dhe në ankim, të cilat do të ndikonin në zgjidhjen e çështjes. Shkeljet e evidentuara kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të ligjit material, pasi pretendimet nuk janë ngritur në drejtim të pavlefshmërisë së akteve administrative, por për anulimin e tyre. Sipas Kodit të Procedurave Administrative, anulimi është e drejtë e organit që ka nxjerrë aktin, e organit epror ose e një organi tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj, ndërkohë që kjo e drejtë nuk u është njohur subjekteve për ta kërkuar atë në gjykatë. Mungesa e një vendimi të arsyetuar ka vënë në dyshim të drejtën e kërkueses për t’u dëgjuar për pretendimet e saj, si dhe aksesin substancial. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë paraqitet kontradiktor në përmbajtje, pasi, nga njëra anë, shprehet se rekursi është paraqitur brenda afatit ligjor dhe është regjistruar në vitin 2017 dhe, nga ana tjetër, për rekursin e DAP-it shprehet se është paraqitur në datën 31.05.2024, pra 2 muaj jashtë afatit ligjor, ndërkohë që ai është paraqitur në datën 02.04.2024, pra brenda afatit ligjor.

8.2. *Parimit të disponibilitetit dhe të paanshmërisë*, pasi Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë janë shprehur tej objektit të padisë, duke zgjeruar

kërkimet dhe duke vendosur edhe për sa i takon pagës dhe rikthimit në detyrë, megjithëse një kërkim i tillë nuk ishte parashtruar ndonjëherë përpara tyre. Zgjerimi i kërkimeve tej atyre të kërkuara në padi bie ndesh me vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Subjekti nuk ka përcaktuar të drejtën që kërkon të mbrojë nëpërmjet gjykatës, nuk ka individualizuar se cili është qëllimi i ngritjes së padisë, si dhe pasojat që kërkon të rregullohen në gjykim, ndaj gjykata e apelit ka vepruar në shkelje të nenit 28 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar objektin e mosmarrëveshjes, duke shkelur nenin 459 të KPC-së dhe ka vepruar *ex officio* në tejkalim të kufijve të shqyrtimit të mosmarrëveshjes, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka pranuar dhe nuk ka kundërshtuar ndryshimin e objektit të padisë nga gjykata e apelit. Kjo ka sjellë, për pasojë, që vendimi i gjykatës së apelit të jetë i metë, ndërsa procesi në atë gjykatë dhe në Gjykatën e Lartë të jetë kryer vetëm formalisht.

8.3. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi procedura e gjykimit të kësaj çështjeje ka zgjatur 11 vjet, ndërsa procesi i rigjyimit në Gjykatën e Lartë ka zgjatur 9 muaj, ndërkohë që për shkak se po gjykohej një çështje e rikthyer ajo duhej të ishte shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar. Kjo ka sjellë tejkalimin e çdo afati kohor referuar nenit 399/2 të KPC-së dhe ndonëse çështja nuk paraqitej komplekse, referuar sjelljes së autoriteteve, është e dukshme që gjykatat kanë pasur vonesa të pajustificuara. Gjykatat kanë dështuar në përdorimin e mjeteve procedurale për përshpejtimin e zgjidhjes së themelit. Kohëzgjatja e paarsyeshme e shqyrtimit të kësaj çështjeje ka rritur në mënyrë artificiale detyrimin e kërkueses për pagimin e pagave deri në rikthimin në detyrë të paditëses.

9. ***Subjekti i interesuar, DAP-i***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i bazuar, pasi është shkelur:

9.1. *Standardi i arsytimit të vendimit i lidhur me të drejtën e aksesit*, sepse Gjykatës së Lartë i mungon analiza dhe pasqyrimi i argumenteve për mospranimin e rekursit. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim pretendimin me natyrë kushtetuese për mungesë të arsytimit të vendimit të gjykatës së apelit për përdorimin e institutit të anulimit, duke lënë pa përgjigje zbatimin e saktë të ligjit dhe njëkohësisht duke mos e riparuar këtë shkelje. Gjykata e Lartë vetëm i ka rreshtuar shkaqet e rekursit, por nuk i ka analizuar ato, pavarësisht natyrës kushtetuese të tyre. Vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të dhëna të gabuara, pasi rekursi ka qenë i palëve të paditura dhe është depozituar në vitin 2024. Rekursi i depozituar nga Avokatura e Shtetit është nënshkruar për të dyja institucionet, kërkuesen dhe DAP-in, siç rezulton nga faqja e

fundit e tij. Gjykata e Lartë nuk i ka kushtuar rëndësinë dhe kujdesin e duhur shqyrtimit të shkaqeve të rekursit.

9.2. *Parimi i disponibilitetit dhe i paanshmërisë*, pasi në gjykim është kërkuar vetëm anulimi i akteve administrative, ndërsa gjykata e apelit jo vetëm ka konstatuar pavlefshmërinë e akteve, por edhe ka detyruar kërkuesen ta rikthejë subjektin në punë dhe të paguajë pagat deri në rikthimin e saj. Ndërhyrja e parregullt e gjykatës së apelit në disponibilitetin e kërtimeve nuk është analizuar nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka marrë në konsideratë as pretendimin se vendimi i rekursuar binte ndesh me fuqinë detyruese të vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të asaj gjykate, gjë që ka sjellë, për pasojë, edhe cenimin e *pritshmërive të ligjshme në drejtim të parimit të sigurisë juridike* për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore.

10. *Subjekti i interesuar, Adelina Bistri*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuësja është një organ që i përket pushtetit ekzekutiv dhe ushtron funksione publike, ndërsa mosmarrëveshja ka për objekt marrëdhëniet e punës me një individ të punësuar pranë saj. Aktet administrative të dala prej kërkueses dhe prej subjektit tjetër të interesuar, DAP-it, i cili gjithashtu ushtron funksione publike, të cilat kanë sjellë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë disponuar në disfavor të kërkueses dhe në favor të punonjëses. Në këto rrethana, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës përmes ankimit kushtetues individual, mbështetur në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, me qëllim

verifikimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të pretenduar si të cenuar nga gjykatat e zakonshme.

13. Kushtetuta, në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, parashikon shprehimisht se Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në të, ndërsa, sipas nenit 16, të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara prej saj, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve. Dispozitat kushtetuese janë detajuar në Ligjin Organik të Gjykatës, ku në nenin 71 të tij, termi kushtetues “*individ*” që Kushtetuta përdor në nenet 131 dhe 134, është zgjeruar duke përfshirë aty edhe “*personat juridikë*”, që mund të jenë edhe subjekte të së drejtës publike.

14. Në kontekst të këtyre parashikimeve, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se kriteri *ratione personae* shqyrtohet me nismën e saj, çmon të analizojë paraprakisht disa çështje juridike, që kanë të bëjnë me të drejtën e “*personit juridik*”, kur ky i fundit vepron si subjekt i së drejtës publike, për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues ndaj çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, konkretisht: (i) nëse personi juridik është bartës i të drejtave themelore kur ushtron pushtet publik; (ii) cilat të drejta themelore përputhen me qëllimet e përgjithshme të veprimtarisë së ushtrimit të pushtetit publik dhe me thelbin e atyre të drejtave; (iii) nëse mund të paraqesë ankim kushtetues individual për të mbrojtur të drejtat themelore.

15. Në nivel parimor, Gjykata vë në dukje se rendi juridik ka për detyrë të respektojë dhe të mbrojë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, të cilat janë vlerë themelore e tij (*neni 3 i Kushtetutës*) dhe se organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet t'i respektojnë ato, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre (*neni 15 i Kushtetutës*). Në rastin e ankimit kushtetues individual, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi ka përballë shtetin (që ushtron pushtetin publik) dhe kërkon të mbrohet nga shkeljet e organeve publike, duke kundërshtuar për këtë qëllim çdo akt të pushtetit publik ose çdo vendim gjyqësor të nxjerrë gjatë ushtrimit të funksionit publik. Nëse ankimi kushtetues individual paraqitet nga një organ publik, atëherë vihet në diskutim jo vetëm hapësira e të drejtave kushtetuese themelore që gëzojnë këto lloj subjektsh, por edhe mbrojtja kushtetuese e këtyre të drejtave themelore që ofron neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, përkundrejt një akti të pushtetit publik, pra përballja e institucionit publik përkundrejt vetë shtetit.

16. Në jurisprudencën e saj deri më sot, Gjykata ka pranuar ankime kushtetuese individuale të paraqitura nga organet publike, duke vënë theksin te të drejtat procedurale, me arsyetimin se ankimi kushtetues individual për shkeljen e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin procedural nuk mund të kufizohet për asnjë subjekt, përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë (*shih vendimet nr. 23, datë 20.04.2016; nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës*

*Kushtetuese*). Ndërsa në një rast nuk ka pranuar kalimin për shqyrtim në seancë plenare të ankimit kushtetues individual të paraqitur nga një person juridik publik për shkak të mospërbushjes së kriterit paraprak të legjitimitetit që lidhet me kriterin *ratione temporis*, pasi kërkesa ishte paraqitur në Gjykatë përtej afatit ligjor 4-mujor (*shih vendimin nr. 46, datë 03.03.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

17. Gjykata vë në dukje se rastet e referuara, në të cilat ajo ka shqyrtuar ankimet kushtetuese individuale të paraqitura nga personat juridikë publikë, i ka trajtuar në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ndërkohë, pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, që reformuan thellësisht ankimin kushtetues individual, juridiksioni i Gjykatës është zgjeruar duke përfshirë kontrollin e çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të gjitha të drejtat kushtetuese, pra edhe të drejtat substanciale. Kjo reformë kushtetuese dhe ligjore është reflektuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës, e cila po i shqyrton të drejtat kushtetuese procedurale të lidhura dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave substanciale nga shkeljet eventuale që vijnë nga ushtrimi i pushtetit publik.

18. Gjykata, duke synuar që ankimi kushtetues individual të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen sa më të përshtatshme të të drejtave dhe lirive themelore të individit, çmon se ka vend për zhvillimin e qasjes së saj edhe në drejtim të vlerësimit të ankimit kushtetues individual (*locus standi*, për sa i takon kriterit *ratione personae*) të paraqitur nga personi juridik publik.

19. Në këtë kuadër, Gjykata çmon të evidentojë se Kushtetuta, në nenin 16, pika 2, parashikon se të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet kushtetuese, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e të drejtave, lirive dhe detyrimeve përkatëse. Për rrjedhojë, një person juridik nuk është automatikisht bartës i një të drejte themelore ose garancie kushtetuese, por ka vend t'i nënshtrohet një testi me dy hapa. Në hapin e parë duhet të vlerësohet nëse e drejta themelore ose garancia kushtetuese e pretenduar përputhet me qëllimin për të cilin personi juridik ekziston dhe vepron, pra nëse evokimi i asaj të drejte është në përputhje me statusin, funksionin dhe veprimtarinë e tij në raportin juridik konkret. Kurse në hapin e dytë duhet të vlerësohet nëse natyra dhe thelbi i asaj të drejte ose garancie lejojnë shtrirjen e saj te personi juridik, pa cenuar funksionin kushtetues dhe qëllimin mbrojtës të saj. Në këtë kuptim, hapi i parë lidhet me përputhshmërinë e së drejtës së pretenduar me funksionin dhe qëllimin e personit juridik, kurse hapi i dytë lidhet me natyrën, thelbin dhe funksionin mbrojtës të së drejtës themelore ose garancisë kushtetuese të pretenduar. Vetëm nëse këto dy kushte plotësohen në mënyrë kumulative, e drejta themelore ose garancia kushtetuese mund të konsiderohet e zbatueshme për personin juridik në fjalë.

20. Në vijim të sa më sipër, Gjykata thekson se të drejtat kushtetuese duhet të interpretohen nën dritën e zhvillimeve, me qëllim reflektimin e standardeve më të larta në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, të drejtat kushtetuese procedurale vlerësohen të lidhura dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave substanciale nga shkeljet eventuale që vijnë nga ushtrimi i pushtetit publik, me veprime ose mosveprime. Kjo do të thotë se, pavarësisht natyrës dhe qëllimit të ankimit kushtetues individual, personat juridikë, kur ushtrojnë pushtet publik, nuk mund të pranohen si ankues për mbrojtjen e të drejtave themelore të tyre, pasi ky mjet ankimi nuk mund të shërbejë për të mbrojtur të drejtat kushtetuese të personit juridik publik, përkatësisht të shtetit, kundër shkeljeve të pushtetit publik. Megjithatë, ky përfundim nuk ka karakter absolut, ndaj, nga pikëpamja kushtetuese, personat juridikë publikë, si rregull, nuk mund të legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës, përveç rasteve kur argumentojnë në mënyrë të mjaftueshme se janë bartës të një të drejte themelore ose garancie kushtetuese të shkelur, që përputhet me qëllimin e veprimtarisë së tyre dhe me thelbin e asaj të drejte ose garancie, dhe që nuk mund të mbrohet me mjete të tjera, përveçse nëpërmjet ankimit kushtetues individual. Ky përjashtim vlerësohet në përputhje me kriteret e sipërpërmendura për zbatueshmërinë e së drejtës ose garancisë kushtetuese ndaj personit juridik. Në këtë këndvështrim, rol vendimtar për legjitimimin e një personi juridik publik ka statusi ligjor i tij, natyra e aktivitetit që kryen, konteksti i mosmarrëveshjes objekt kontrolli, si dhe shkalla e pavarësisë së tij nga pushteti publik.

21. Nga sa më lart, Gjykata, duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e ankimit kushtetues individual, vlerëson se të drejtat themelore, në parim, zbatohen në mënyrë të kufizuar për personat juridikë që veprojnë në sferën e të drejtës publike. Për këtë arsye, si rregull, këto subjekte nuk legjitimohen për të përdorur mjetin juridik të ankimit kushtetues individual për mbrojtjen e të drejtave themelore. Me fjalë të tjera, personat juridikë të së drejtës publike, kur ushtrojnë pushtet publik, kanë akses të kufizuar si ankues, pasi ky mjet është konceptuar për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përkundrejt veprimeve ose mosveprimeve të pushtetit publik. Në këtë kuptim, përfshirja e ankimeve të këtyre subjekteve në kontrollin kushtetues duhet të vlerësohet me kujdes, pasi shqyrtimi i aspekteve të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, i ngritur nga një person juridik publik, mund të ndikojë në funksionin kushtetues të ankimit individual si mjet mbrojtjeje i të drejtave themelore përkundrejt ushtrimit të pushtetit publik.

22. Duke iu kthyer çështjes konkrete, në zbatim të testit të mësipërm, Gjykata vëren se kërkuesja është një ministri, pra person juridik publik, e cila, në marrëdhënien e shërbimit civil objekt shqyrtimi, ka vepruar si autoritet administrativ dhe si punëdhënëse publik. Qëllimi i saj i përgjithshëm lidhet me ushtrimin e funksioneve publike dhe zbatimin e ligjit në interes publik. Gjykata konstaton se kërkuesja ka ngritur disa pretendime në kuadër të së drejtës për proces të

rregullt ligjor, konkretisht në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të drejtën për mjet juridik efektiv, parimin e disponibilitetit dhe të paanshmërisë, si dhe të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Këto pretendime përbëjnë garancitë kushtetuese konkrete mbi të cilat kërkuesja mbështet kërkimin e saj për cenimin e procesit të rregullt ligjor. Megjithatë, pavarësisht emërimit dhe përmbajtjes së tyre, këto garanci procedurale, në thelbin e tyre, synojnë mbrojtjen e subjektit të cenuar nga ushtrimi i autoritetit publik dhe parandalimin e arbitraritetit në vendimmarrje. Për rrjedhojë, ato janë konceptuar kryesisht për subjektet ndaj të cilëve ushtrohet pushteti publik, dhe jo për vetë organet publike, të cilat, në rendin kushtetues, bartin detyrimin për t'i respektuar dhe garantuar ato. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se vlerësimi i mësipërm nuk nënkupton mohimin, në plan abstrakt, të natyrës kushtetuese të garancive procedurale të nenit 42 të Kushtetutës, por lidhet me mungesën e legjitimitetit të kërkueses, si person juridik publik në rrethanat konkrete të çështjes, për t'i evokuar këto garanci si titullare. Duke i vlerësuar pretendimet e kërkueses në dritën e kriterëve të mësipërme dhe nenit 16, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata çmon se ngritja e pretendimeve se ajo është bartëse e këtyre garancive procedurale, me qëllim kundërshtimin e papranueshmërisë së rekursit në Gjykatën e Lartë dhe të mënyrës së zhvillimit të procesit gjyqësor, nuk përputhet as me qëllimet e përgjithshme të këtij personi juridik publik në raportin e shërbimit civil, as me thelbin e këtyre garancive si të drejta themelore mbrojtëse. Në këto kushte, kërkuesja nuk paraqitet si titullare e këtyre të drejtave për qëllimet e legjitimitetit kushtetues, sipas objektit të kërkesës. Nën këtë optikë, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk plotëson kriterin *ratione personae*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

23. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkuesja nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 28.01.2026**

**Shpallur më 02.03. 2026**

## MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3805, datë 03.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, bashkohem me shumicën për rrëzimin e kërkesës, por ndahem prej tyre për mënyrën e arsytimit, duke mbajtur qëndrimin se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, por nuk përmbush kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*, pasi pretendimet dhe argumentet e parashtruara prej saj në ankimin kushtetues individual janë të pabazuara.

2. Konkretisht, nga rrethanat e analizuara në vendim, rezulton se kërkuesja, në cilësinë e punëdhënësit, ka nxjerrë një akt administrativ për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, i cili është bërë objekt kundërshtimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Këto të fundit kanë kontrolluar ligjshmërinë e veprimtarisë së kërkueses dhe kanë konkluduar se veprimet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nuk kanë qenë në përputhje me ligjin, ndaj akti në fjalë është i paligjshëm. Kontrolli kushtetues për procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme është bërë objekt kërkimi nga kërkuesja nëpërmjet mjetit të ankimit kushtetues individual, me pretendimin se gjykatat kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në disa drejtime, sipas garancive të nenit 42 të Kushtetutës.

3. Shumica, megjithëse ka vënë në dukje se Gjykata ka shqyrtuar më herët ankimet kushtetuese individuale të paraqitura nga personat juridikë publikë, ka vendosur të ndryshojë qasjen duke argumentuar se një person juridik nuk është automatikisht bartës i një të drejte themelore ose garancie kushtetuese, por kjo e fundit (e drejta ose garancia) mund të konsiderohet e zbatueshme nëse përmbush në mënyrë kumulative dy kushte që lidhen me përputhshmërinë e së drejtës së pretenduar me funksionin e qëllimin e personit juridik dhe me natyrën, thelbin e funksionin mbrojtës të së drejtës themelore ose garancisë kushtetuese të pretenduar. Sipas shumicës, nga pikëpamja kushtetuese, rol vendimtar për legjitimitimin e një personi juridik publik ka statusi ligjor i tij, natyra e aktivitetit që kryen, konteksti i mosmarrëveshjes objekt kontrolli, si dhe shkalla e pavarësisë së tij nga pushteti publik. Përfshirja e ankimeve të personave juridikë të së drejtës publike, kur ushtrojnë pushtet publik, në kontrollin kushtetues duhet të vlerësohet me kujdes, pasi shqyrtimi i aspekteve të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, i ngritur nga një person juridik publik, mund të ndikojë në funksionin kushtetues të ankimit individual si mjet mbrojtjeje i të drejtave themelore përkundrejt ushtrimit të pushtetit publik (*shih paragrafët 19 - 21 të vendimit*).

4. Ndahem nga ky qëndrim i shumicës dhe vlerësoj të qëndroj në qasjen e deritanishme të Gjykatës për legjitimitimin e personave juridike publikë për vënien në lëvizje të kontrollit

kushtetues. Kjo, pasi çmoj se fryma e kushtetutëbërësit, kur ka normuar në nenin 131, shkronja “f”, të Kushtetutës, të drejtën e çdo individi për t’iu drejtuar Gjykatës, ka qenë ofrimi i një mjete në nivel kushtetues për të siguruar dhe për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore për çdokënd ndaj çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor. Jo pa qëllim kjo normë kushtetuese nuk ka bërë asnjë lloj specifikimi referuar elementeve të atilla që lidhen me aftësinë/zotësinë e individit në raport me mënyrën e organizimit ose të qëllimit të veprimtarisë së tij. Me fjalë të tjerë, nisma për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues nuk kushtëzohet nga lloji i personit fizik ose juridik ose nga karakteri i tij publik a privat, por nga natyra e pretendimeve që parashtrohen përpara Gjykatës dhe në mënyrë të veçantë kur personi juridik ka qenë palë në një proces gjyqësor dhe pretendimet e tij lidhen me respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Në këtë drejtim, sjell në vëmendje jurisprudencën e deritanishme të Gjykatës, e cila ka bërë dallimin e legjitimitimit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale nga legjitimimi i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. E drejta për akses në gjykatë, si një e drejtë e natyrës procedurale, duhet të respektohet dhe të përdoret nga çdo subjekt që konsiderohet palë në një proces dhe që preket në mënyrë të drejtpërdrejtë prej tij. Një e drejtë e tillë nuk mund të cenohet, sepse duke qenë një element i së drejtës në tërësi dhe që rrjedh nga thelbi i shtetit të së drejtës, garanton barazinë e palëve në procesin gjyqësor. Për këtë arsye, ankimi në Gjykatë për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet për asnjë subjekt, përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë (*shih vendimet nr. 23, datë 20.04.2016; nr. 14, datë 03.06.2009; nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Nën dritën e sa më sipër, vë në dukje se pushtetin publik në gjykimin e zakonshëm e ushtron gjykata dhe jo ndonjë nga palët ndërgjyqëse, kushdo qoftë ajo - shtet/entitet publik ose privat/individ. Mënyra si gjykata ka ushtruar pushtetin kur prek të drejtat sipas neneve 16, pika 2, dhe 42 të Kushtetutës, i nënshtrohet *per se* kontrollit kushtetues, i cili vepron pavarësisht nëse personi juridik publik - shteti del humbës ose fitues në përfundim të gjykimit. Kjo do të thotë se legjitimimi i personit juridik publik nuk mund të përjashtohet ose të pranohet *apriori*, por duhet të provojë përpara Gjykatës se gëzon cilësitë ligjore për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Në këtë këndvështrim, personi juridik publik duhet të konsiderohet si palë e barabartë në gjykimin kushtetues kur ka ushtruar të drejta ose pushtete që i burojnë nga Kushtetuta dhe nuk mund të përjashtohet nga qasja në drejtësinë kushtetuese. Gjykata ka si funksion të saj jo vetëm shqyrtimin e ankimit kushtetues individual, kur ka për objekt kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme nga individët bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, por edhe mosmarrëveshjet kur palë është personi juridik, edhe kur ai ushtron pushtet publik bazuar në nenin 16, pika 2, të saj.

6. Në përmbledhje të këtyre argumenteve, çmoj se pavarësisht se kërkuesja është person juridik publik, ajo legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë e paditur në procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme dhe është bartëse e të drejtave kushtetuese, ndaj përmbush kriterin për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues, por duke qenë se pretendimet dhe argumentet e parashtruara prej saj, në vlerësimin tim, janë të pabazuara në themel, për këtë shkak, kam ndarë mendimin për rrëzimin e kërkesës.

**Anëtare: Marjana Semini**